# DËSHMI ARKIVI

**A-437824**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Mauzoleumi i zbuluar në Bulqizë, finalist për Çmimin Ndërkombëtar “Palmyra” |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/kulture/mauzoleumi-i-zbuluar-ne-bulqize-finalist-per-mimin-nderkombetar-palmyra-i585529` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 12 shtator 2026, 07:09:17 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 12 shtator 2026, 09:06:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `1431df519bd85dbb90f040a49749e36aef4eca52dd9507af474b25c40a2e8d78` |
| TEKSTI | `844908e3db7a755ca243fe72a900c0f946e14cf9416bce94eaeaeb18f2270abb` |
| PAMJA | `c362dbbc6af33251a33cbb56b78d9ee8d46dcfbe6dc9b16567696c5430877369` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `39e32592f2ee8afc726663f1bb6c24fa3ce51cc1dbb106a3d38d71f1e51ed95e` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/39e32592f2ee8afc726663f1bb6c24fa3ce51cc1dbb106a3d38d71f1e51ed95e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Mauzoleumi i zbuluar në Bulqizë, finalist për Çmimin Ndërkombëtar "Palmyra"

12 Shtator 2026, 11:06Kulturë TEMA

Mauzoleumi i zbuluar në Bulqizë, finalist për Çmimin

Kërkimet e fundit arkeologjike të zhvilluara në Strikçan të Bulqizës, të cilat zbuluan një varr monumental të llojit mauzoleum, janë përzgjedhur zyrtarisht si finalistë për Çmimin Ndërkombëtar të Zbulimit Arkeologjik "Palmyra".

Njëkohësisht, zbulimi është nominuar edhe për "Çmimin Special". Këto vlerësime prestigjioze do të prezantohen në kuadër të edicionit të 28-të të Bursës Mesdhetare të Turizmit Arkeologjik (BMTA), i cili do të zhvillohet nga data 29 tetor deri më 1 nëntor 2026, në Paestum, Itali.

Renditja në listën e 5 zbulimeve arkeologjike më të rëndësishme të vitit në nivel global, së bashku me zbulimet e kryera në sitet e njohura si Pompeii, Vulci, Egjipt dhe Turqi, është dëshmi e potencialit të lartë shkencor që mbart ky zbulim.

Pjesëmarrja e shtetit tonë në këtë event për herë të parë, nëpërmjet këtij zbulimi, është një mundësi e shkëlqyer për promovimin e trashëgimisë sonë kulturore në arenën ndërkombëtare.

Ky monument i veçantë ofron të dhëna thelbësore të reja e të rëndësishme arkeologjike, historike e epigrafike, në një zonë të pastudiuar më parë dhe hedh dritë mbi dinamikat sociale, organizimin e elitave lokale dhe arkitekturën funerare gjatë periudhës romake të vonë në Luginën e Bulqizës e më gjerë.

Nëpërmjet këtij zbulimi, hapet një kapitull i ri studimi që ndihmon për të kuptuar më shumë mbi rrjetet e komunikimit dhe transformimet sociale në brendësi të provincave gjatë kësaj periudhe.

Ky sukses është rezultat i punës kërkimore sistematike në kuadër të projektit "Kërkime Arkeologjike në Luginën e Bulqizës" i realizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Instituti i Arkeologjisë, të cilët përgëzojnë drejtuesit e projektit, ekipin e gërmimit dhe të gjithë bashkëpunëtorët për përkushtimin dhe profesionalizmin e dëshmuar në zbulimin, dokumentimin dhe promovimin e kësaj pasurie kombëtare.

Për të mbështetur nominimin për "Çmimin Special" të publikut mund të bëheni pjesë duke klikuar butonin "Like" (Pëlqej) në posterin përkatës të projektit në këtë link:

https://www.facebook.com/share/1F84QcArKL/

A.K./TemA

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Rikthehet në Pogradec Festivali i Monodramës “Albamono”

09:04 Kulturë

Dea e Butrintit kthehet në Shqipëri

21:10 Kulturë / 3 komente

DEBATI/ Frederik Ndoci: Ja pse diktatura nxori artistë dhe prodhoi filma më të mirë

17:22 Kulturë / 8 komente

Fillon së shpejti Java Kulturore e Turqisë

15:21 Kulturë

Nis fushata e regjistrimit të artizanëve

13:18 Kulturë

Pikaso

12:14 Kulturë / 1 koment

Më 23 shtator, në Tiranë hapet ekspozita kushtuar piktorit Ibrahim Kodra

11:16 Kulturë

Çelet edicioni i XIX-të i Festivalit Folklorik Tipologjik Kombëtar të Këngës Popullore Qytetare në Elbasan

09:15 Kulturë / 1 koment

VIDEO/ Alfabeti për shkrimin e shqipes dhe lidhjet me Kishën Ortodokse, studiuesi Yll Rugova shpjegon çfarë tregojnë dokumentet për Dhaskal Todhrin

17:55 Kulturë / 8 komente

Kujtesa e numrave

17:17 Kulturë / 2 komente

### Më të lexuarat

**24 oret e fundit**

**Javen e fundit**

**PROFIL: Kush është ministri i ri i Brendshëm?**

10:40 Kronika / 74 komente

**Genti Tare: SPAK bëri show me Igli Taren, e mbajti 6 orë ...**

10:50 Politika / 52 komente

**PISA, hakmarrja europiane për mësueso-fobët shqiptarë**

16:18 Politika / 39 komente

**Audiopërgjimi i Ahmetajt dhe akuzat për trafik armësh, qe...**

11:15 Politika / 74 komente

**Nga ndërhyrja te Trump, te Samiti i NATO-s! Thaçi për Ram...**

11:30 Politika / 36 komente

## Blog Tema

**Haga, midis maktheve dhe paranojave**

21:25 Blog / 1 koment

**Haga, midis maktheve dhe paranojave**

21:00 Blog / 1 koment

**Parku i Liqenit me syte nga qielli dhe SPAK**

19:26 Blog / 7 komente

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit REGJISTROHU
Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

Built and Monetized by

- Politika
- Kronika
- Editorial
- Blog
- Bota
- Sport
- Shëndeti
- Turizëm
- Sociale
- Ekonomia
- Antena
- Rajoni
- Kulturë
- Lifestyle
- Dossier
- Hi-Tech

- Kontakt
- Te dhënat personale
- Cookies

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.